

KONTRATË SHITJE KUOTASH KAPITALI

TË SHOQËRISË "BIG KORÇA" SH.P.K

Sot me date 23.05.2024 ortaku i shoqërisë BIG KORÇA shpk, Vladimir Lleshaj dhe e interesuara shoqëria B-Ideal Group e përfaqësuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj u mbledhën për të nënshkruar kontratën e shitjes së kuotave ku:

SHITESI:

Vladimir Lleshaj, i datelindjes 08.04.1978 pajisur me kartën e identitetit H80408150T, zoterues i 1 kuote ekuivalente me 49% të kapitalit me vlerë 7 350 000 leke.

BLERESI:

Shoqëria B-Ideal Group pajisur me NIPT M31722025S e përfaqësuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord të nënshkruajnë Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "BIG KORÇA" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Neni 1

Marreveshja themelore

Shoqëria "BIG KORÇA" sh.p.k, është regjistruar në QKB e pajisur me NIPT L74313001Q, me seli në Rrugë "Kico Greco", Lagjja 8, Zona kadastrale nr. 8564, Pasuria e Paluajtshme me Nr. 3/919 Vol.38, Faqe 20, Korce, me ortake si më poshtë:

Vladimir Lleshaj zoterues i 1 kuote ekuivalente me 49% të kapitalit me vlerë 7 350 000 leke

Shoqëria BIGALB GROUP e përfaqësuar nga administratori i saj Znj. Elona Koshi zoteruese e 1 kuote ekuivalente me 51% të kapitalit me vlerë 7 650 000 leke



Ne vendimin date 23.05.2024, asambleja e ortakeve te shoqerise ka miratuar shitjen e kuotave te zoteruara nga pala shitese Vladimir Lleshaj ne favor te pales blerese shoqeria B-Ideal Group pajisur me NIPT M31722025S e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj dhe konkretisht:

Pala shitese Vladimir Lleshaj i shet pales blerese shoqerise B-Ideal Group 1 kuote qe perfaqeson pjesmarrjen ne perqindje 49% te kapitalit te shoqerise "BIG KORÇA" shpk.

Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe menyra e likujdimit

Çmimi i plotë i shitjes së kuotave është 7 350 000 si me poshte:

Vladimir Lleshaj ka rene dakort ti shesi pales blerese shoqerise B-Ideal Group nëpërmjet shitjes se 1 kuote qe perfaqesojne 49% te kapitalit te shoqerise, kundrejt cmimit 7 350 000 leke shume e cila eshte likujduar nga pala blerese ne favor te pales shitese.

Pas ketij veprimi, shoqeria do do te kete 2 kuota qe do te zoterohen nga ortaket si me poshte:

Shoqeria B-Ideal Group zoteruese e 1 kuote ekuivalente me 49% te kapitalit me vlere 7 350 000 leke

Shoqeria BIGALB GROUP zoteruese e 1 kuote ekuivalente me 51% te kapitalit me vlere 7 650 000 leke

Neni 3

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

Kontrata do te regjistrohet ne QKB qysh ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate ndersa Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësi te Blerësit do të kryhet menjehere.

Neni 4

Garancitë



Fq. 2

Shitësi në lidhje me kuoten që zotëron, garanton Blerësin:

1. Se është pronar i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuota të shitura.
2. Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuota të fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.
3. Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.
4. Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme të shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.
5. Palet shitese me nënshkrimin e kësaj kontrate, heqin dorë përfundimisht nga pronësia mbi kuotat që shet, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kalojnë palet blerese.

Neni 5

Regjistrimi

Regjistrimi i kontratës për kalimin e kuotave nga Shitësi te Blerësi në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 6

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 7



Fq. 3

Dispozitat e fundit


Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Kontrata redaktohet ne dy kopje origjinalë konform rregullave dhe ligjeve dhe me vullnet të lirë nënshkruhet nga palët.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITESI

Vladimir Lleshaj

Vladimir Lleshaj


BLERESI

Shoqeria B-Ideal Group

e perfaqesuar nga administratori i saj Vladimir Lleshaj

Vladimir Lleshaj